



AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

Në pajtim me nenin 10.2, 10.3 dhe 10.4 të Rregullores të UNMIK-ut Nr. 2003/13 (me ndryshime), Komisioni për Lista të 20%-it të Punëtorëve (“Komisioni”), pas shqyrtimit të Listës fillestare të punëtorëve të NSh “Unimont” në Prizren, e cila i është nënshtruar privatizimit me datë **10 maj 2011**, më datë 22 dhe 23 dhjetor 2017 ka shpall Njoftimin për Vendim lidhur me personat të cilët nuk i kanë përmbushur të gjitha kriteret ligjore për t’u përfshirë në listë të ndërmarrjes së lartcekur. Komisioni pas identifikimit **të një lëshimi teknik në vendimin e publikuar lidhur me punonjësin Ercan Shpat i lindur me 01.06.1956**, konform nenit 50, paragrafi 1, të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative Nr. 05/L-031, me datë 28 dhjetor 2017, shpall këtë **korrigjim** të:

NJOFTIM PËR VENDIM

Bazuar në dëshmitë e prezantuara lidhur me z. ERCAN SHPAT si ish punonjës i NSh “Unimont” Prizren, Komisioni ka konstatuar se i njëjti nuk i ka përmbushur të gjitha kriteret ligjore të kualifikueshmërisë për t’u përfshirë në listë, konform nenit 10.4 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2003/13 (me ndryshime).

Arsyetim

Z. ERCAN SHPAT nuk ka ofruar dëshmi të mjaftueshme që ka qenë i regjistruar si punëtorë në kohën e privatizimit të ndërmarrjes, deri më date 10 maj 2011.

SHËNIM ME RËNDËSI:

Komisioni bazuar në dëshmitë e ofruara lidhur me udhëheqësinë e NSh-së ka qenë i keqinformuar që z. Ercan Shpat ka ushtruar funksionin e Udhëheqësit të NSh-së. Gjersa bazuar në disa dokumente tjera (procesverbale) të NSh-së udhëheqësi i kësaj NSh-je ka ndërruar jetë në vitin 2006.

Komisioni lidhur me këtë lëshim teknik kërkon falje punëtorit në fjalë.

Këshilla Juridike:

Pala e pakënaqur mund të ankohet ndaj këtij Vendimi, Komisionit për Shqyrtimin e Ankesave ndaj Listave Fillestare të Punëtorëve, në Agjencinë Kosovare e Privatizimit, brenda 20 (njëzet) ditësh, nga dita e fundit të shpalljes së Listës Fillestare, përkatësisht të këtij Vendimi.

Komisioni i Listave të 20%-it të Punëtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP)